



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 05 Maj 2021

Nr: 351

VENDIM

Objekt: Për shqyrtimin administrativ të denoncimit për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj z. Françesko Muçaj, Drejtor në Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës Vlorë

Kërkues: Lëvizja Socialiste për Integrim

Ndaj: Z. Françesko Muçaj, Drejtor në Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës Vlorë

Baza ligjore: Nenet 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe ‘n”, pika 2, dhe 91, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, neneve 60, 61, dhe vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimi nr. 9, datë 09.03.2021 “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata gjatë procesit të hetimit administrativ,

VËREN:

I

Vlerësimi paraprak

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, është raportuar një denoncim në ndërfaqen e “Aktiviteteve të



Data: 05 Maj 2021
Nr. 351

Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj z. Françesko Muçaj, Drejtor në Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës Vlorë

Ndaluar”, në rubrikën “Kallëzo”, nga subjekti politik Lëvizja Socialiste për Integrim për një veprimtari të z. Françesko Muçaj, e cila bie në kundërshtim me vendimin nr. 9 datë 24.12.2020.

Kallëzimi i paraqitur nga kallëzuesi ruhet në sistem elektronik dhe identifikohet me numër unik të gjeneruar nga sistemi. Në denoncimin e raportuar më datë 07.04.2021 me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID nr. 2973, ora 18:19, në ndërfaqen e KQZ-së pretendohet se: *“Më datë 05.04.2021, ish-Drejtoresha e Drejtorisë Tatimore Vlorë dhe kandidatë për deputetë e Partisë Socialiste zj. Pranvera Resulaj, ka postuar në faqen e saj zyrtare Facebook një veprimtari publike ku kishte marrë pjesë dhe Françesko Muçaj, Drejtor në Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës Vlorë, njëkohësisht ka dhe statusin e nënpunësit civil, me mbishkrimin “ Me Frankon, takuam banorët e Rajonit 3, në zonën e ish-Fabrikës së Orizit. Pyetje të mençura që të bëjnë të mendohesh mirë për përgjigjen dhe reflektosh, sepse kjo është një përgjegjësi që mund të mbahet vetëm me mbështetjen e qytetarëve”.*

Bashkangjitur këtij denoncimi është dërguar si mjet provues link-u i facebook që vërteton pjesëmarrjen e z. Françesko Muçaj në këtë aktivitet të zj. Pranvera Resulaj.

Sipas përcaktimeve të nenit 23, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shqyrtoi paraprakisht kërkesat lidhur me kompetencën e organit publik për shqyrtimin e tij.

Sipas përcaktimeve të neneve 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

- dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
- f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
- n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Referuar nenit 7, të ligjit 10 279 datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”, kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Të ndodhur në kushtet që data e kryerjes së aktivitetit dhe postimit të tij në facebook mund të jenë të zhvendosura në kohë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 4272 prot., datë 22.04.2021 i ka kërkuar z. Françesko Muçaj informacion në lidhje **me datën**, orën, vendin dhe pjesëmarrjen mbi këtë aktivitet të zhvilluar.

Z. Françesko Muçaj ka dërguar pretendimet e tij në lidhje me këtë aktivitet, nëpërmjet shkresës protokolluar pranë KQZ me nr. 4272/1 prot., datë 29.04.2021, ku ka vërtetuar se aktiviteti është **kryer në datën 04.04.2021.**

Referuar nenit 8, të vendimi nr. 9, datë 09.03.2021 *“Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, në rastet kur KQZ nuk është organi kompetent dhe/ose nëse **mungojnë indiciet e besueshme për të nisur hetimin administrativ**, Komisioneri vendos refuzimin për nisjen e hetimit administrativ.*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi paraprakisht denoncimin, vlerësoi se provat ku denoncimi bazohet, nuk përbëjnë indicie për nisjen e hetimit administrativ. Referuar kalendarit të vitit 2021, data 04.04.2021, ditë në të cilën është zhvilluar dhe aktiviteti, korrespondon ditë e dielë, ditë pushimi. Referuar nenit 6, pika 4, të vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 përcaktohet se, *“Punonjësi i administratës shtetërore, **vetëm pas orarit zyrtar të punës dhe jashtë mjediseve të institucioneve shtetërore**, ka të drejtë të marrë pjesë në veprimtari politike apo zgjedhore të një subjekti zgjedhor ose kandidati në zgjedhje”*, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson së pjesëmarrja e z. Françesko Muçaj në aktivitetin me pjesëmarrës kandidatin për deputet zj. Pranvera Resulaj, nuk bie në kundërshtim me dispozitat e vendimit nr. 9 datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në KQZ, pasi është kryer **jashtë orarit zyrtar të punës dhe jashtë mjediseve të institucioneve shtetërore**. Në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk mund të fillojë një procedurë administrative të kërkuar nga denoncuesi për shkak se informacioni apo të dhënat e treguara nuk krijojnë një bazë të mjaftueshme për të hetuar administrativisht shkeljet.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, 91 dhe 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 60 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimi nr. 9 datë 24.12.2020 dhe vendimit nr. 9 datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,



V E N D O S:

1. Mosfillimin e procedurës administrative për shkak se informacioni apo të dhënat e treguara nuk krijojnë një bazë të mjaftueshme për të hetuar administrativisht shkeljet.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Illirjan CELIBASHI



Data: 05 Maj 2021
Nr. 351

Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj z. Françesko Muçaj,
Drejtor në Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës Vlorë